



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
SHOQËRIA UJËSJELLËS KANALIZIME DIMAL SH.A.  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

Nr. 36 Prot.

Urë Vajguore, më 17.04. 2023

**VENDIM**

Nr. 03, datë 17.04.2023

**PËR  
PËRFUNDIMIN E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË, SHPALLJEN E SAJ NË  
LIKUIDIM DHE EMËRIMIN E LIKUIDATORIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, sot, më datë 17 Prill 2023, Shoqëria Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Dimal, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT : K32803022R, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë z. Petref Sula, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

**Çështjet e rendit të ditës:**

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

**Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:**

Shoqëria Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Dimal nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 4832 Rep. dhe Nr. 2752 Kol, datë 16.11.2022 midis shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Dimal dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat sh.a, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivitetet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 1.1.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të prishet dhe të çregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

**Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja,**

**VENDOSI :**

1. Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj;
2. Shoqëria Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Dimal shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;

3. Emërimin e z. Petref Sula si likuidator të shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Dimal;

4. Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Korc: G. Hoxha *[Signature]* 23

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE U.K. DIMAL  
KRYETAR I BASHKISË DIMAL**

**JULIANA MEMAJ**

*[Signature]*

